

Laboremus

Tradita e ekselencës

Nëntor 2023



Hisja e Diellit

Kam themelet nën këtë gur...
JAM SHQIPTAR E S'UL FLAMURI!
Me këto vargje u pritën festat patriotike në Fultz. Ishin nxënësit e Klubit të teatrit ata që mes emocioneve të shumta arritën të vënë me sukses në skenë dramën "Hisja e Diellit" në datë 22 Nëntor.

faqja 2



Automotive Albania



Ky panair ndodh një herë në dy vite, dhe këtë vit, shkolla jonë rimori pjesë me projekte të reja të zhvilluara nga nxënësit e talentuar të Departamentit të Automekanikës. Gjatë ditëve 26-29 tetor në praninë e mësuesve të fushës dhe të disa prej të diplomuarve të këtij viti, nxënësit prezantuan projekte realizuar nga vetë ata, siç ishin: "Go Kart Electric" e organizuar për rastin e 100 vjetorit të shkollës, "Avion Projekti Magnus" - një avioni që shpjegon Efektin Magnus të ngritja e avionëve nga pistat e fluturimit, si dhe "Motor V6" - një motor me djegie të brendshme të krijuar nga nxënësit e viteve të 12-a.

faqja 2

Fituesit e olimpiadave

Olimpiadat janë organizime të cilat synojnë të promovojnë nxënësit me prirje në fusha të ndryshme, qofshin shoqërore apo shkencore. Kjo traditë e përvitshme u zhvillua dhe në shkollën tonë, një shkollë me kompetenca të larta. Çdo vit e më shumë vihet re një interes i shtuar i nxënësve për të marrë pjesë në olimpiadat e lëndëve të ndryshme, ku ekziston zgjedhja e tyre sipas preferencave vetjake. Këtë vit fazat e para të olimpiadave u zhvilluan në datat 14-22 nëntor nga vitet e para deri në vitet e katërta në rang shkollash.



faqja 3

PJESËMARRJA NË VEPRIMTARINË ASIG

Në shtëpinë me gjethe

Aftësimi profesional TEG

Fuqizimi i heronjve të së nesërme: Kryqi i Kuq Shqiptar sjell trajnimin e ndihmës së parë në Fultz.

NJË VIZITË NË BUNK'ART

Shkolla "Harry Fultz" në promovimin e librit "N'votër"

Prezantimi i projekteve në ExpoCity

Njeriu, një qenie plot ambicie dhe ...

INTERVISTË ME ISH KRYEREDAKTORIN E GAZETËS

Redaksia "Laboremus"

Grupi

Faqja 3

Faqja 3

Faqja 4

Faqja 4

Faqja 4

Faqja 5

Faqja 5

Faqja 5

Faqja 6

Faqja 6

Faqja 6

Faqja 6

Hisja e Diellit

“Naeallnik m’i hiq taboret ...
mos ma shkel barin mbi vorret...
mos ia thuej lokes atë fjalë...
mos m’i kthe ti krushqit dalë...”

Kam themelet nën këtë gur...
JAM SHQIPTAR E S’UL FLAMUR!”

Me këto vargje u pritën festat patriotike në Fultz. Ishin nxënësit e Klubit të teatrit ata që mes emocioneve të shumta arritën të vënë me sukses në skenë dramën “Hisja e Diellit” në datë 22 Nëntor. Edhe pse shfaqja u realizua në një kohë të shkurtër nxënësit e klubit dhe mësueset Brikena Bejo e Iris Hajdini, bënë një punë intensive duke ia arritur të paraqesin një shfaqje dinjitoze. Me përgjegjësinë e prezantimit të figurave historike nxënësit dolën në skenë me zemrat që u rrihnin fort e zërat që iu dridheshin por ia dolën t’i menaxhojnë këto emocione si profesionistë të vërtetë dhe të dhurojnë një shfaqje plot mesazhe. Veprimtaria u shoqërua me duartrokitje të ngrohta që treguan se ishte bërë një punë e bukur dhe e realizuar. Autori i mirënjohur Fadil Kraja arriti të jetë edhe një herë mes nesh me anë të kësaj drame e cila transmetoi një ndjenjë patriotike të papërshkrueshme dhe tregoi më së miri dashurinë e shqiptarit për atdheun.



Pavarësisht se drama përqendrohet në vitin 1913, kohë kur sapo ishte vendosur kufiri i ri i shqiptar, ajo është ende aktuale, pasi Shqipëria mbetet ende një shtet me kufij shqiptaro-shqiptarë. Ndaj është e rëndësishme që ne të kujtojmë përherë historinë e të parëve tanë e gjithë jetët e humbura për një shtet të pavarur që sot të mund ta gëzojmë të lirë. Ashtu siç Isa Boletini tregoi përpara ministrit anglez se Shqipëria nuk shpërbëhet e se shqiptari sa të ketë jetë do të luftojë me gjithë ç’ka për atdheun e tij, edhe ne nuk duhet të harrojmë misionin që kemi për ta bërë vendin tonë më të mirë e ta lartësojmë përherë emrin e tij me krenari. Prania e Ismail Qemalit edhe pse jo si një personazh i dramës u ndje fuqishëm duke treguar lidhjen Shqipëri – Kosovë që nuk do të shuhet kurrë. Personazhi i Skënderit dhe ai i Lokes vunë në fokus mënyrën si shqiptarët janë rritur dhe sakrificat e vështirësitë që kanë përjetuar.

Le të na shërbejnë këto “plagë” të së shkuarës si frymëzim për të ruajtur me fanatizëm traditat tona të veçanta e kulturën tonë autentike e të pakrahasueshme. Askush nuk mund ta dojë vendin tonë më shumë se ne e askund nuk mund të ndihemi më mirë se në Atdhe. Le të jemi heronj të çdo dite të vendit tonë duke qenë qytetarë të mirë, duke u përmirësuar, zhvilluar bashkë me të e duke respektuar dhe lartësuar simbolet kombëtare për të cilat është luftuar ndër shekuj. “Unë njëqind herë jetën e jap, po kurrë armën, nderin, Flamurin dhe Atdheun tim!” (Isa Boletini)

Erisa Jano

Automotive Albania

Automotive Fair Albania, një veprimtari kur marrin pjesë shkolla profesionale dhe jo vetëm, ka për qëllim: promovimin e industrisë dhe kulturës automobilistike, informimin e pjesëmarrësve rreth zhvillimeve të fundit në sektorin e transportit rrugor. Ky panair bën të mundur një shkëmbim përvojë ndërmjet pjesëmarrësve, si dhe krijimin e mundësive për intership profesional për nxënësit e sektorit automotive.

Pjesë e këtij organizimi ishin dhe kompani të njohura të fushave të ndryshme që mundësuan mjete të reja automobilistike, aksesore, pjesë ndërrimi për automjete dhe mjete historike “Retro”.

Ky panair ndodh një herë në dy vite, dhe këtë vit, shkolla jonë rimori pjesë me projekte të reja të zhvilluara nga nxënësit e talentuar të Departamentit të Automekanikës. Gjatë ditëve 26-29 tetor në praninë e mësuesve të fushës dhe të disa prej të diplomuarve të këtij viti, nxënësit prezantuan projekte realizuar nga vetë ata, siç ishin: “Go Kart Electric” e organizuar për rastin e 100 vjetorit të shkollës, “Avion Projekti Magnus” - një avioni që shpjegon Efektin Magnus të ngritja e avionëve nga pistat e fluturimit, si dhe “Motor V6” - një motor me djegie të brendshme të krijuar nga nxënësit e viteve të 12-a.

Këto projekte nuk ishin vetëm një demonstrim e aftësive teknike të nxënësve, por gjithashtu shfaqën pasionin e tyre për inovacionin dhe përmirësimin në fushën e automjeteve. Shumë personalitete të sukseshme të kësaj fushe shprehën interes për punimet, e realizuara nga “Departamenti i Automekanikës.” Mbështetja motivuese e pozitive që morën nga të pranishmit dhe përfaqësuesit e tjerë i bënë nxënësit tanë të ndihen të vlerësuar dhe i nxiyën drejt projekteve të reja praktike, premtuese në fushën e automekanikës. Kjo pjesëmarrje e suksesshme i inkurajon më shumë për të vazhduar një rrugëtim të gjatë me guxim dhe përkushtim.



Me krenari për ju, “Harry Fultz” vazhdon të kontribuojë në fushën e automekanikës, duke përgatitur nxënës të talentuar dhe të përkushtuar për të ardhmen e industrisë automobilistike.

Anduela Alla

Pjesëmarrja në veprimtarinë ASIG

Në datën 14 Nëntor, shkolla jonë mori pjesë në veprimtarinë e "ASIG", një veprimtari e cila mbledhi grupet përfaqësuese të gjimnazëve të ndryshme në Tiranë, si një mënyrë për të nxitur nxënësit e pasionuar pas Gjeografisë në kombinimin e dijeve teorike me teknologjinë. Veprimtaria u organizua te Qendra e Teknologjisë dhe Inovacionit si një nismë e ASIG për të përhapur më shumë informacion rreth gjeoportalit. Për shumë prej studentëve ishte hera e parë që punohej me një teknologji të tillë dhe patjetër që ishin tepër të interesuar dhe kureshtarë për të mësuar më shumë rreth krijimit të hartave duke shfrytëzuar pajisje të ndryshme teknologjike. Kjo veprimtari ishte gjithashtu mjaft interesante duke qenë se u organizua në formën e një konkursi mes 9 gjimnazëve pjesëmarrës:

- 1)Gjimnazi "Ismail Qemali"
- 2)Gjimnazi "Sami Frashëri"
- 3)Gjimnazi "Petro Nini Luarasi"
- 4)Gjimnazi "Qemal Stafa"
- 5)Gjimnazi "Partizani"
- 6)Gjimnazi "Arben Broci"
- 7)Gjimnazi "Sinan Tafaj"
- 8)Shkolla e Mesme Profesionale "Harry Fultz"
- 9)Shkolla e Mesme Profesionale "Karl Gega"



Skuadra përfaqësuese e shkollës sonë përbëhej nga mësuesja e lëndës Evelina Noga dhe nxënësit: Klara Agolli, Ami Qana, Markus Mara, Alkeo Kërkeza dhe Erin Çeçja.

Pas veprimtarisë, e gjithë skuadra jo vetëm që kishte fituar një përvojë të re dhe mjaft të vlefshme, por gjithashtu ndiheshin të lumtur që provuan diçka të re për të cilën nuk kishin informacion më parë.

Markus Mara



Fituesit e olimpiadave

Olimpiadat janë organizime të cilat synojnë të promovojnë nxënësit me prirje në fusha të ndryshme, qofshin shoqërore apo shkencore. Kjo traditë e përvitshme u zhvillua dhe në shkollën tonë, një shkollë me kompetenca të larta. Çdo vit e më shumë vihet re një interes i shtuar i nxënësve për të marrë pjesë në olimpiadat e lëndëve të ndryshme, ku ekziston zgjedhja e tyre sipas preferencave vetjake. Këtë vit fazat e para të olimpiadave u zhvilluan në datat 14-22 nëntor nga vitet e para deri në vitet e katërta në rang shkollash.



Të gjithë nxënësit të cilët arritën të kalonin fazën e parë, kanë filluar përgatitjet për përfaqësimin dinjitoz të shkollës në fazat e ardhshme.

Është i dukshëm mundimi i tyre që shprehet konkretisht me rezultate të tilla e shpresojmë t'ia arrijnë qëllimit të tyre përfundimtar.

Armando Shkëmbi

Në shtëpinë me gjethe

Shkolla "Harry Fultz" prej disa vitesh është pjesë e konkursit, që zhvillon shtëpia me gjethe. Ky konkurs ka si synim të nxisë shprehjen e mendimit dhe të ndjenjave mbi të kaluarën komuniste nga brezi i ri, në formë artistike, duke pasur si burim frymëzimi, vizitën në Muzeun Kombëtar "Shtëpia me gjethe", ku nxënësve të shkollës sonë iu dha përsëri mundësia për të qenë pjesë e kësaj vizite.

Kjo shtëpi ka 31 dhoma të lidhura mes tyre, brenda të cilave ndodhet një histori e rëndë. Secila nga këto dhoma mban detaje nga regjimi komunist në Shqipëri. Muzeu i kushtohet njerëzve të pafajshëm që u arrestuan, torturuan dhe vuajtën dënime të rënda për shkak të përgjimeve, kontrolleve e spiunimeve në periudhën e diktaturës, shumica e të cilave kryheshin nga kjo shtëpi.



Me hyrjen në muze, nxënësit u takuan me drejtuesen, e cila do t'i shoqëronte gjatë vizitës së tyre. Përmes një koleksioni të pasur dhe autentik të aparaturave të spiunazhit nga më modernet për kohën që fshihej brenda saj, përmes dokumenteve të shumta arkivore, dëshmimeve filmike dhe statistikave apo studimeve, nxënësit arritën të kuptojnë problemet e shumta të regjimit komunist.

Me ngjitjen në katin e dytë të muzeut, nxënësit u prezantuan me punime të ndryshme si: piktura, mokete, filma etj, që kanë qenë pjesë e konkursit që zhvillon shtëpia me gjethe për disa vjet me rradhë. Gjithashtu iu dha mundësi për të vizituar dhe disa dhoma të tjera me emrat e personave të dënuar dhe të tortuar gjatë diktaturës.

Në fund nxënësit morën një libër, të titulluar "Mbresa", ku përfshiheshin punimet e nxënësve të shkollave të ndryshme fitues të këtij konkursi në vite. Nuk mungonin aty, punimet e nxënësve tanë. Suksese në konkursin e këtij viti!

Ami Qana



Aftësimi profesional TEG

Vizita e fundit nga studentët e Departamentit të Biznesit ishte një mundësi për të fituar njohuri në fushën e marketingut dhe burimeve njerëzore. Ajo që e bëri këtë përvojë veçanërisht pasuruese ishte shtrirja e saj – ajo nuk u kufizua vetëm në qendrën pritëse, por u shtri në kompani të ndryshme të lidhura me Grupin Balfin.

Teksa studentët hynë në mjedise, pati një ndjenjë të menjëhershme profesionalizmi dhe gjallërie. Atmosfera hapi terrenin që studentët të zhyten në veprimtarinë e përditshme të një biznesi. Duke ecur nëpër korridorët dhe hapësirat komunale të punës, ata vëzhguan strukturën organizative dhe thithën pulsën e vendit të punës.



Prezantimet e marketingut dolën të ishin një pikë kryesore e vizitës. Ata siguruan një dritare në botën e shitjeve dhe promovimeve duke zbuluar strategjitë që nxisin fushata të suksesshme. Studentët ishin në gjendje të lidhin konceptet teorike të mësuara në klasë me aplikimet e tyre praktike, veçanërisht në përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve të komunikimit për të synuar në mënyrë efektive audiencën.

Në segmentin e burimeve njerëzore, studentët u thelluan në proceset e rekrutimit, trajnimit dhe zhvillimit të punonjësve. Ky eksplorim hodhi dritë mbi rolin kryesor të një ekipi të motivuar në suksesin e çdo organizate. Dëshmimi i këtyre praktikave në veprim ndihmoi në tejkalimin e hendekut midis njohurive teorike dhe zbatimi në botën reale.

Vizita përfundoi me sesione interaktive që përfshinin diskutime me profesionistë të industrisë. Këta dialogë jo vetëm që zgjeruan bazën e njohurive të studentëve, por gjithashtu ofruan mundësi të vlefshme rrjetëzimi. Angazhimi me ekspertë me përvojë i lejoi studentët të parashtronë pyetje, të ndajnë njohuri dhe të krijojnë lidhje që mund të çojnë në bashkëpunime të ardhshme. Si përmbledhje, kjo vizitë nuk ishte thjesht një ekskursion edukativ; ishte një eksplorim gjithëpërfshirës i marketingut dhe burimeve njerëzore në shumë subjekte të lidhura me Grupin Balfin. Përvoja praktike e fituar gjatë kësaj vizite pritet të luajë një rol kryesor në rritjen akademike dhe profesionale të studentëve, duke u ofruar atyre një kuptim të ri të funksionimit të ndërlikuar të peizazhit të biznesit.

Sindi Çafaj



Fuqizimi i heronjve të së nesërmes: Kryqi i Kuq Shqiptar sjell trajnimin e ndihmës së parë në "Fultz".

Kryqi i Kuq Shqiptar bashkë me mësuese Zamira Shkurti, zhvilluan së fundmi një takim sensibilizues me nxënësit e shkollës, duke i informuar mbi rëndësinë e dhënies së ndihmës së parë në kohë nevojë. Takimi u fokusua në përgatitjen e nxënësve me aftësi thelbësore për shpëtimin e jetës, duke u shfaqur demonstrime praktike të teknikave të ndryshme të ndërhyrjes.

Gjatë takimit, ekspertët e Kryqit të Kuq shfaqën teknika praktike të ndihmës së parë, duke ofruar demonstrime praktike për të siguruar që nxënësit të fitojnë një kuptim gjithëpërfshirës të aftësive të nevojshme për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive në situata kritike. Nga kujdesi bazë për plagën e CPR, vullnetarët mbuluan një sërë procedurash thelbësore të ndihmës së parë, duke i inkurajuar nxënësit të veprojnë me shpejtësi dhe besim kur përballen me urgjencë.



Kryqi i Kuq Shqiptar është i përkushtuar ndaj nismave të tilla, duke besuar se një komunitet i mirëpërgatitur është i pajisur më mirë për t'iu përgjigjur me efektivitet urgjencave. Ndërsa studentët tanë përqafojnë njohuritë e tyre të reja, ata nuk janë thjesht nxënës; ata janë ambasadorë të sigurisë, të gatshëm për të bërë një ndikim pozitiv kudo që të shkojnë.

Si përfundim, vizita e Kryqit të Kuq Shqiptar jo vetëm që na ka pajisur me aftësi jetëshpëtuese, por gjithashtu ka ndezur një ndjenjë përgjegjësie dhe gatishmërie brenda shkollës.

Ergis Hoda

Një vizitë në BUNK'ART

Një grup nxënësish, të shoqëruar nga mësuesit e lëndës së historisë, u përfshinë në një vizitë didaktike për historinë e pasur të Shqipërisë në Bunk'Art Tirana. Në këtë muze të vendosur nën tokë, nxënësit eksploruan korridorët e nëndheshme dhe njohën detaje të fshehura të historisë së kohës së diktaturës shqiptare. Ata shëtitën nëpër ekspozitat që përfshinin fotografi, armë, dhe mjete të përgjimit të përdorura gjatë kësaj periudhe të historisë sonë. Nxënësit përjetuan një rrugëtim emocionues nëpër kujtesën e errët të vendit tonë. Ekskursioni në Bunk'Art Tirana pasqyroj një përvojë të pasur kulturore duke shtuar dimensione të reja në njohurinë e nxënësve lidhur me të kaluarën historike të vendit të tyre.

Klea Zalli



Shkolla “Harry Fultz” në promovimin e librit “N’votër”

Në një atmosferë plot emocione dhe pasion për letërsinë, shkolla “Harry Fultz” mori pjesë në promovimin e librit “N’votër”, shkruar nga autorja e talentuar Enxhi Sheta. Promovimi i librit u mbajt në 22 Nëntor në bibliotekën e Kryeministrit dhe u organizua nga Qendra për Hapje dhe Dialog, duke sjellë së bashku nxënës, mësues dhe të ftuar të interesuar për botën e letërsisë.

Autorja Enxhi Sheta, ndau me pjesëmarrësit një rrëfim të veçantë rreth librit të saj. Ajo shpjegoi procesin e krijimit të “N’votër” dhe ndau me ne pikat kyçe të ngjarjeve dhe personazheve që përbëjnë historinë e saj. Me një stil të shkëlqyer shkrimi dhe një pasion të dukshëm për temat që prek libri, ai u prezantua si një vepër e veçantë e letërsisë së re shqiptare.

Promovimi u zhvillua në një nga mjediset e bibliotekës së Kryeministrit. Nxënësit, mësuesit, dhe të ftuar të tjerë kishin rastin të njiheshin me autoren, të bënin pyetje dhe të ndjenin më shumë thellësinë e veprës.



Mësuesit e Enxhit folën me pasion dhe krenari për rritjen dhe suksesin e saj. Ata e shoqëruan Enxhi Shetën në këtë udhëtim, fillimisht si një vajzë me pasion për letërsinë dhe më pas si një shkrimtare e suksesshme duke theksuar përkushtimin dhe punën e palodhur që ka bërë për të arritur deri këtu. Libri “N’votër” shfaqet si një frymëzim i madh për të gjithë nxënësit e shkollës “Harry Fultz”, inkurajuar nga vështirësitë dhe sukseset e autorës. Ngjarja u përshëndet me një ndjesi krenarie dhe frymëzimi, duke bërë që ky promovim të kujtohet si një moment i jashtëzakonshëm i lidhur me pasionin dhe fuqinë e fjalës së shkruar.

Mateo Tollumi

Prezantimi i projekteve në ExpoCity

Panairi i organizuar në ExpoCity përgjatë dy ditëve ishte një mundësi shumë e mirë për të ekspozuar të gjitha punimet e robotikës së shkollës sonë. Ishte një eveniment mjaft i madh dhe i mirëorganizuar me grupe përfaqësuese nga të gjitha gjimnazet e Tiranës. Atmosfera ishte shumë e këndshme dhe gjithashtu kishte dhe një shkëmbim idesh midis skuadrave të ndryshme. Shkolla jonë ishte pjesëmarrëse, me stendën e saj ku ishin prezantuar të gjitha projektet e realizuara nga vitet e dyta deri në të katërtat e robotikës. Projektet ishin të shumta dhe gjithashtu kishte shumë të interesuar të cilët zgjodhën të vizitonin nga afër panairin. Kishte dhe shumë kompani të cilat ishin të interesuara ndaj projekteve inovative dhe me ndikim në fusha të ndryshme të biznesit. Kjo përvojë dy ditore ishte mjaft interesante dhe e vlefshme, pasi jo vetëm promovoi punët e grupit të robotikës për të cilat është punuar shumë, por në të njëjtën kohë shërbeu dhe si një mënyrë e pjesëmarrësve për të fituar aftësi komunikative dhe bashkëpunuese, të cilat duhet theksuar, janë mjaft të rëndësishme.

Sara Cela



Njeriu, një genie plot ambicie dhe ...

Ndër vite jemi njohur me zhvillimin e shoqërisë, ku kemi parë se si gjërat janë përmirësuar. Pothuajse gjithçka është bërë më e lehtë dhe kjo vetëm për një arsye më se të thjeshtë... qenia njerëzore. Ne kemi kthyer në realitet ide të cilat na ngjasonin si të paarritshme më parë. Kemi thyer tabu, për të cilat askush nuk do të guxonte të mendonte se do të thyheshin ndonjëherë. Kemi provuar e provuar me vite të tëra dhe në fund ia kemi dalë mbanë të krijojmë, edhe nga hiçi, për ta bërë jetën tonë të tillë, të bukur, të lehtë, të përbalueshme.

Jemi me fat që jetojmë në një kohë të tillë. Të parët tanë nuk kanë pasur këto mundësi që ne shijojmë sot. Ndoshta këto do të thonë dhe të tjerët pas nesh, nuk i dihet, por për momentin jemi ne ata që mund ta themi me plot bindje diçka të tillë, edhe pse jo të gjithë...

Ambicia jonë drejt të panjohurës na ka shtyrë të kthejmë ëndrrat në realitet, na ka bërë të besojmë tek një ardhme më e mirë, por përse vallë kjo e ardhme nuk është e njëjtë për të gjithë?! Shohim njerëz që vuajnë, njerëz që vajtojnë për të dashurit e tyre, njerëz që nuk e njohin se çështje të ndihesh i gëzuar. Kemi synuar gjatë gjithë kohës të shohim vetëm përpara dhe dalëngadalë, si pa kuptuar, jemi kthyer në qenie të mekanizuara, pa shpirt.

Çdo ditë e më tepër përballemi me vdekjen, urinë, vuajtjen, mosbarazinë dhe duket sikur askush nuk bën diçka për të ndryshuar situatën. Ne, njerëzit e thjeshtë, realizojmë përpjekjet tona, por sado të përpiqemi, nuk kemi në dorë fatin e botës. Janë të tjerë ata që e kanë në dorë diçka të tillë. Njerëz ambiciozë, por të paiterësuar për botën përreth.



Pamja e një fëmije që del çdo ditë në rrugë për të kërkuar një copë bukë, sepse vetëm për atë mendon; mamaja që qan për vdekjen e pashpirt të fëmijëve të saj të vegjël, bashkimi i një kombi që vuan për shkak të problemve të dikurshme që dukeshin si të harruara, por në fakt nuk kanë qenë kurrë të tilla; për këto mendojmë ne, populli i thjeshtë, i solidarizuar në çdo çast të ditës. Edhe për ndodhinë më të vogël, në cepin më të largët e të papërfillshëm, me të cilin nuk na lidh asgjë, të shumtë janë njerëzit që derdhen lot, mendojnë: “Po sikur të isha unë në vendin e tyre?”. Është lidhja shpirtërore, ajo lidhje që dalëngadalë, për disa individë po zhduket dita-ditës.

Por pse nuk përpiqen të ndryshojnë? Përse, kur kanë kaq shumë pushtet, nuk mendojnë për ata që nuk dinë se ku ndodhen, ata të cilët për kushedi të satën ditë, mbyllin sytë rrugëve të qytetit, me shpresën e vakët se një ditë fati do të jetë me ta? Të gjithë i kemi këto mendime që kaplojnë mendjen tonë, përveç atyre, “më të rëndësishmëve”. Ndoshta gabohem që në një periudhë si kjo, kur të gjithë festojnë, shprehem për diçka të tillë. Por në fakt, jo të gjithë festojnë. Ka nga ata që, po jetojnë një ditë të zakonshme, aty, mes dhimbjes e trishtimit. E kanë harruar festën, ndoshta nuk e kanë përjetuar kurrë dhe për ta duhet të mendojmë sot. Festat na bëjnë të bashkuar, sepse e tillë është fryma e tyre, prandaj le të mendojmë vetëm një çast për ata që kanë nevojë për pak ngrohtësi e mbështetje, sepse dhe ata e meritojnë të ndihen si ne. Fjalët mund të jenë boshe; veprat janë ato që vlejnë, por dijeni se kështu nis gjithçka, me shpresën se një ditë këto fjalë do të kthehen në realitet...

Fjordi Toti



Intervistë me ish kryeredaktorin e gazetës

Redaksia “Laboremus” është tashmë një traditë e shkollës sonë. Për të afruar më shumë nxënësit me përvojën mediatike, organizuam një intervistë me ish-redaktorin e gazetës, Matias Mirdita, i cili na tregon më shumë rreth përvojës së tij në redaksi dhe aftësive që fitoi gjatë këtij rrugëtimi.

1. Duke marrë parasysh faktin se keni qenë dhe më parë në redaksinë e gazetës së shkollës, çfarë ju shtyu për të marrë përsipër drejtimin e saj?

Pjesëmarrja ime në gazetë ishte rastësore nga klubi i debatit ku ish kryeredaktori Drini Beçi, përmendi se gazeta po kërkonte prurje të reja dhe më shtyu që të shkruaja një artikull si aplikim për hyrjen në stafin e “Laboremus”-it. Në fund të vitit të dytë nga përvojat pozitive që kishim pasur më parë së bashku më pyeti nëse isha i interesuar të merrja përsipër drejtimin e gazetës. Gjithmonë kam dashur të sfidoj veten dhe aftësitë e mia drejtuese ndaj vendosa që ky pozicion do të ishte një mundësi e shkëlqyer për të eksploruar një fushë relativisht të re për mua: korrekturën letrare.

2. Çfarë do të veçoje si momentin më të bukur gjatë punës si kryeredaktor?

Nga puna e bërë në gazetë ka plot momente të bukura por asnjë nuk ia kalon shpërblimit të punës së bërë kur sheh që nxënësit i lexojnë me vëmendje artikujt. Gjithashtu shpeshherë merrja përshtypje dhe nga shokët e klasës për punën që po bënim. Nuk ka gjë më të bukur se të shikosh që mundimi ynë nuk shkon pa u vënë re.

3. Gjatë gjithë rrugëtimit cilat faza kanë qenë për ju më sfidueset?

Faza më sfiduese e punës ka qenë periudha para provimeve të maturës ku niveli i angazhimit duhej mbajtur i njëjtë por ngarkesa e stafit të cilët ishin ashtu si unë maturantë u shtua ndjeshëm. Oraret në të cilët duhej të punonim ne u bënë shumë më fleksibël në varësi të konsultimeve ndërkohë që presioni për t’ia dalë në kohë dukej sikur vetëm rritej.

4. Nëse ktheheni pas, çfarë cilësish mendoni se keni fituar gjatë punës me gazetën?

Personalisht mendoj se puna me gazetën më mësoi të isha më i hapur ndaj reagimeve të ndryshme të individëve dhe si të përshtasja mënyrën e komunikimit në varësi të situatës dhe faktorëve që e rrethojnë. Gjithashtu ishte një ndihmë e madhe për rritjen e nivelit të shkrimeve të mia duke përfutur nga stilet e ndryshme të anëtarëve të grupit të gazetës.

5. Sa i rëndësishëm është për ju bashkëpunimi mes ekipit për një produkt përfundimtar të lavdërueshëm?

Pa bashkëpunim e mirëkuptim nga të gjitha palët gazeta nuk realizohet dot. Është si një makineri ku çdo hallkë lidhet me tjetrën dhe nëse të gjitha pjesët nuk punojnë siç duhet e gjithë makineria ngec dhe puna vështirësohet tej mase.

6. Çfarë këshille keni për të gjithë nxënësit të cilët dëshirojnë t’i bashkohen redaksisë së shkollës sonë?

“Laboremus” ka për qëllim kryesor jo vetëm nxjerrjen në pah të gjithë veprimtarive që organizon “Fultz”-i, por edhe t’i aftësojë pjesëtarët në punën në grup, teknikat e shkrimit dhe punën kërkimore. Pra, secili mund të gjejë veten dhe të japë kontributin në mënyrën e tij. Faleminderit për kontributin tuaj!

Emi Gjokutaj



Redaksia “Laboremus”

Në çdo vit të ri shkollor “Harry Fultz” gëlon nga talente të reja, nxënës me ambicie dhe synime për të ardhmen. Disa prej tyre kanë zgjedhur t’i bashkohen dhe gazetës “Laboremus”.

Çdo ditë e më tepër kuptojmë sa shumë mund të arrijmë duke qenë një grup kaq i bashkuar këtu në redaksinë tonë. Me njerëzit e duhur dhe nën drejtimin dhe udhëzimin e stafit të mësuesve, që ndjekin prej kaq vitesh të përkushtuar këtë organizim, na vjen mirë që përgatisim të rinj sidomos nga ana profesionale. Jo vetëm duke iu zgjeruar horizontin dhe duke ua dhënë mundësinë e një shoqërimi më të gjerë, por edhe duke i përballur me përgjegjësitë e një mjedisi shumë afër me atë të punës.



Puna sapo ka filluar dhe jemi më entuziastë se kurrë që, t’ju mbajmë në dijeni për zhvillimet më të fundit në lidhje me shkollën dhe më gjerë. Inkurajojmë këdo që dëshiron t’i bashkohet familjes sonë “Laboremus” me ide të reja dhe aftësi për të kryer punën e një gazetari serioz. Dhe së fundmi duam t’i urojmë suksese stafit të gazetës për vitin 2023-2024.

Danja Sharxhi

Grupi

KRYEREDAKTORE: EMI GJOKUTAJ
DIZENJUES: LINOR BEQIRI
GRUPI BASHKËPUNUES:
MËSUESE SUELA SHALA
MAKSIMILIAN MYZEQRI
ERISA JANO
KLARA AGOLLI
ANDUELA ALLA
MARKUS MARA
ARMANDO SHKËMBI
AMI QANA
SINDI CAFAJ
ERGIS HODA
MATEO TOLLUMI
FJORDI TOTI
DANJA SHARXHI

